



Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri

Një projekt i financuar nga Bashkimi Europian



Projekti zbatohet nga

**Franca (partner Senior) dhe
Italia (partner Junior)**



Deklaratë për shtyp

Nëpunësi Civil: Çelësi i Suksesit për një Administratë Evropiane Ftesë e hapur për të mësuar mbi procedurat e rekrutimit

Ngritja e një administrate publike të kualifikuar mbetet një prioritet kryesor për procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Procedurat e rekrutimit të nëpunësve civile janë në fokusin e qeverisë shqiptare, me objektiv përfundimtar ngritjen e një administrate publike efiçente.

Në 4 prill 2016, në ambientet e fakultetit të Shkencave Sociale do të organizohet një aktivitet për vlerësimin e progresit të arritur në procesin e rekrutimit në administratën publike.

Konferenca, e cila synon të promovojë ecurinë e deritanishme të zbatimit të Strategjisë për Reformën në Administratën Publike, do të ketë dy sesione. Në sesionin e parë do të bëhet një analizë e procedurave të rekrutimit, sfidat që priten në të ardhmen dhe rekomandimet për të përballuar këto sfida nga institucionet publike.

Sesioni i dytë do të fokusohet të aspektin praktik të procesit të rekrutimit. Në të njëjtën kohë, një panair pune do të mbahet në hyrjen kryesore të fakultetit, ku studentët do të kenë mundësi të shohin nga afër procesin e rekrutimit. Ky panair pune do të shërbejë si një urë lidhëse midis institucioneve të administratës publike dhe kandidatëve potencialë për nëpunës civilë.

Sfondi i aktivitetit:

Aktiviteti është konceptuar të ketë dy sesione të cilat do të zhvillohen në sallën e konferencës “AULA MAGNA” të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Në sesionin e parë do të bëhet një prezantim i pamjes së përgjithshme të zbatimit të strategjisë, parë nga sytë e aktorëve kryesorë të përfshirë në procesin e zbatimit e saj. Në këtë sesion do të flasin edhe aktorë të tjerë të cilët do të sjellin perspektivën si duket procesi nga jashtë. Sesioni i dytë do të fokusohet në aspektin praktik të procesit të rekrutimit. Folësit do të theksojnë hapat e nevojshëm që duhen ndjekur për të pasur një proces të suksesshëm aplikimi, si dhe përfitimet e të qenët pjesë e administratës publike.

Ftesa:

Konferenca do të organizohet në datën 4 prill 2016, në orën 10:00, në mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale në Tiranë. Dëshirojmë të ftojmë në këtë aktivitet çdo person që është i interesuar për t'u informuar mbi procedurat e rekrutimit, të cilat janë pjesë e Strategjisë për zbatimin e Reformës në Administratën Publike.

Rreth projektit

Projekti “Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri”, projekti i financuar nga BE, filloi aktivitetin në maj 2015. Projekti po zbatohet nga qeveria Franceze dhe Italiane. Synimi i projektit është mbështetja e Qeverisë shqiptare në procesin e forcimit të qeverisjes dhe efikasitetit në sektorin publik. Një objektiv i rëndësishëm i projektit, është mbështetja e Strategjisë hartuar për zbatimin e Reformës në Administratën Publike, ku procedurat e rekrutimit janë një pjesë integrale.